

VENDIM
Nr. 327, datë 29.5.2024

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË DHE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN TË NEGOCIOJNË DREJTPËRDREJT ME SUBJEKTIN NDËRKOMBËTAR *BOSTON CONSULTING GROUP (BCG)* PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË KONSULENCËS, PËR IDENTIFIKIMIN E MEKANIZMAVE EFICIENTË PËR TË NXITUR MË TEJ LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE MUNDËSINË E PËRDORIMIT TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE (IA) PËR KËTË QËLLIM

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, ‘Për prokurimin publik’”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin të negociojnë drejtpërdrejt me subjektin ndërkombëtar *BOSTON CONSULTING GROUP (BCG)* për ofrimin e shërbimit të konsulencës për identifikimin e mekanizmeve eficientë për të nxitur më tej luftën kundër korrupsionit dhe mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) për këtë qëllim.

2. Negocimi ka në objekt këto 3 (tri) fusha:

a) Analizë për identifikimin e mekanizmeve eficientë dhe dhënien e rekomandimeve për luftën kundër korrupsionit, duke u fokusuar në veçanti në rishikimin e funksioneve dhe organizimit institucional të institucioneve të administratës shtetërore, aspekteve së strukturës të sistemit ministror dhe proceseve vendimmarrëse, me qëllim rritjen e eficiencës dhe eliminimin e hapësirave korruptive;

b) Analizë dhe rekomandime, me qëllim parandalimin e korrupsionit në ofrimin e shërbimeve publike përmes rritjes së eficiencës dhe llogaridhënies;

c) Analizë dhe rekomandime për mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale në proceset vendimmarrëse dhe atë të ofrimit të shërbimeve, me qëllim eliminimin e hapësirave të mundshme korruptive.

3. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama